

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tetë të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më :29.08.2023 (e enjte) duke filluar ne ora 10:00.


R e n d i i d i t ë s


1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Prurja e vendimit për Vazhdimin e Memorandumit të Bashkpunimit në mesë të Shoqates së Zjarrfiksive Vullnetar (SH.Z.V) në seli në Gjilan dhe K.K.Novoberdes.
3. Raporti i drejtoris së Bujqësis mbi perfundimin e fushates së Korrijshirjeve.
4. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:19.08.2024
Në: Novobërdë

Kryesuesi i Kuvendit
Mirjana Simijonović





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 12.08.2024, duke filluar në orën 09:15.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, zv.kryesuesi i kuvendit zt.Ramush Mehmeti, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Violeta Milosevic, ZKF Zoran Cvetkovic, Zyrtari i kadastrit Sinisa Markovic, Zyrtari për arsim Flamur Uka, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj korumin prezent janë 12 antarë nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti Financiar i tremujorit të dytë për vitin 2024;
3. Rialukimi i Mjeteve në projekte Kpitale;
4. Informatë rreth perfundimit të vitit shkollor;
5. Informatë dhe raportim rreth suksesit të nxënësve;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: a keni ndonjë propozim për rend të dites?

Sinisa Markovic pasi pershendeti të pranishmit tha: e kemi një propozim nga Drejtoria për Kadaster për aprovimin e listes së veçantë të paluajtshmërisë të Komunës që planifikohet për shfrytëzim për vitin 2024, materialin po besoj që e keni marrë të gjithë pra bëhet fjalë për listen e pronës publike për qytetarët që të mundë ta shfrytëzojnë, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: ta sqarojna pak këtë pikë, ju e dini se ne kemi formuar dy komsione për dhënjë të pronës Komunale në shfrytëzim, Drejtoria e Urbanizmit e kan propozuar listen e pronave që qytetarët mund ti marrin në shfrytëzim, kjo listë do të shpallet përmes ankandit e qytetarët e interesuar mundë të aplikojnë. Kryesuesja e dha në votim rendin e ditës me këtë oikë shtesë të propozuar si dhe konstatoi se në sall janë 10 antarë prezent.

Rendi i ditës u aprovua me 10 vota për nga 10 antarët prezent të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Raporti financiar i tremujrit të dytë për vitin 2024;

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën zyrtarit të Kadastrit.

Sinisa Markovic tha: materialin e keni marrë të gjithë me kohë po besoj, listen e pronave e ka bërë Drejtoria e Kadastrit së bashku me Kryetarin e Komunë unë po e propozoj se po besoj se do ta votoni e më pastaj do të shohim interesimin e qytetarëve për aplikim, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stanojevic tha: mendoj se ky propozim është i mirë dhe duhet të përkrahet, parcela në Zebinc ka njerëz të interesuar, por një parcel në Koretishtë me duket se e ka marrë dikush në shfrytëzim por nuk e di se kush e shfrytëzon atë parcel andaj kerkoj që për mbledhjen e radhes ti kemi ato informata si dhe a paguan për atë parcel.

Sinisa Markovic tha: kemi dy lloje të pronave në shfrytëzim prona Komunale dhe të pylltarisë por vendimi final është nga Ministria, por mendoj se nuk është pronë e jona por e Ministrisë. Sa i perket kësaj liste për këtë list vendos Komuna.

Stojan Stajonevic tha: unë pyeta për hirë të qytetarëve vetem kerkova informat se cila është pronë Komunale dhe cila e Ministrisë.

Dobriboje Djordjevic tha: sa ka të hyra nga këto prona dhe sa parcela janë?.

Sinisa Markovic tha: 6 parcela janë në Koretishtë, 1 parcel te Tregu lidhet ku aty veç se ka filluar të bëhet një deponi, 6 janë në Koretishtë dhe 1 në Kufc.

Selatin Nuhiu tha: vetem e kam një pyetje për zyrtarin për disa prona që janë të kontestuar, njerzit paguajn që 10 vite qira për atë tok por nuk e shfrytëzojnë a është edhe ajo pronë në këtë listë apo jo, e kemi p.sh Remzi Sylja paguan qira por nuk e shfrytëzon ose disa qe e kan marrë pronen por nuk e shfrytëzojn fare dhe as nuk paguan qira, dhe mendoj se atyre duhet të ju mirren pronat.

Ramush Mehmeti tha: vetem e kam një sygjërim që të ken kujdes pasi që është pikë shumë e ndieshme.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 12 vota për nga 12 antarë prezent votohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Aprovohet vendimi për listen e veçantë të propozuar nga ekzekutivi i Komunës për dhënjën e pasurisë së patundshme të Komunës në shfrytëzim nga subjektet juridiko – fizike.

Pika e gjashtë: të ndryshme;

Kryesuesja tha: e kemi përfaqësuesin e OJQ-së nga Kamenica Nebojsa Simic, materialin e keni marrë të gjithë me kohë, bëhet fjalë për një hulumtim që është bërë.

Nebojsa Simic pasi pershendeti të pranishmit tha: jam drejtor i organizates NOPM dhe jam i angazhuar si kordinator në këtë projekt dhe këtë hulumtim e kemi bërë në tri Komuna: në Kamenicë, Novobërdë dhe Ranilluk. Me material i keni marrë disa hulumtime që janë bërë po e shoh se ka disa gabime teknike. Projekti ka për qëllim të ngris vetedijen e qytetarëve për marrjen e vendimeve që në mënyrë paralele të punoj me Komunat dhe ti rrisim kapacitete në organet Komunale. si dhe ata që janë në shërbim të qytetarëve të jetë shërbimi edhe më i mirë, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stonajovic tha: është anket e mirë sidomos te rrjeti pasi që një frym me qenë nuk funksionon rryma si dhe te subvencionet për ndarje të mjeteve bujqësore, menodj se kjo është gjë e mirë nese arrin që të rritet mjete e subvencioneve.

Pranvera Kastrati Gashi e pyeti Kryesuesen se a do të ketë më mbledhje në muajin Guasht?.

Kryesuesja tha: besoj se KPF-ja do të jetë me datë 19 ndërsa Kuvendi me 28 ose 29, shohim e bisedojm.

Mbledhja përfundoi në ora 10:10.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Mirjana Stimijonovic
Kryesuese e Kuvendit

